



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 611/1 prot.

Tiranë, më 13.04.2022

V E N D I M

Nr. 69, datë 13 . 04 . 2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesat me: nr. 227 Regj., nr. 228 Regj., dhe nr. 229 Regj., datë 02.12.2021³, respektivisht të subjekteve ankues: A. T, E. Ç dhe E. Ç, kundër Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli” (në vijim TKEKS), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “përkatësisë në një grup të veçantë⁴”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të parashtruara nga subjektet ankues dhe dokumentacionit të depozituar, rezulton se subjektet ankues kanë lidhur marrëdhënien e punës me TKEKS, në vitin 2014 (Konkretisht, A. T dhe E. Ç kanë lidhur marrëdhënien e punës me TKEKS, me datë 01.09.2014, ndërsa E. Ç ka lidhur marrëdhënien e punës me TKEKS me datë 01.08.2014). Nga nënshkrimi i kontratës së parë individuale të punës e deri me datë 31.08.2021, mes ankuesve (punëmarrësit) dhe TKEKS (punëdhënësi) janë nënshkruar kontrata një vjeçare të njëpasnjëshme, për 7 vite rresht.

Ankuesit, në mes të tjerash informojnë se, që nga fillimi i muajit dhjetor 2020, institucioni nuk i ka angazhuar në asnjë projekt artistik, megjithëse kanë qenë gjithnjë të gatshëm dhe janë aktorë të aftë për të interpretuar role në të gjitha zhanret teatrore. Me anë të e-mailit të datës 01.11.2021,

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

³ Ankesat janë plotësuar me informacion me datë 15.12.2021, referuar procesverbalit datë 15.12.2021, mbajtur pranë Zyrës së KMD-së.

⁴ Grupi i aktorëve të TKEKS.

janë njoftuar nga institucioni për t'u paraqitur për firmosjen e kontratës së re, me afat 6-mujor, të cilën ata të tre kanë refuzuar ta nënshkruajnë.

Bazuar në pretendimet e ankuesve, pas këtij refuzimi, drejtori ka nxjerrë urdhëresa për izolimin e tre aktorëve 8 (tetë) orë në ditë në një ambient, i cili ndodhet në hyrje të derës kryesore të institucionit, ngjitur me vendin e rojes dhe të ndërtuar kohët e fundit enkas për izolimin e aktorëve, duke i hequr të drejtën e pranisë së tyre në ambientet ku punohet. Drejtori ka kërkuar të firmosin orën e hyrjes dhe të daljes nga institucioni.

Subjektet ankues kanë pretenduar se po trajtohen në mënyrë të pabarabartë, pasi vetëm për aktorët është propozuar të nënshkruhet kontrata individuale të punës me afat 6-mujor, në ndryshim nga dy punonjësit e tjerë të trupës artistike, me të cilët punëdhënësi ka firmosur kontrata pune me afat 1-vjeçar. Gjithashtu, vetëm tre aktorëve u kërkohet të zbatohet orari i punës 08.00-16.30, ndërsa pjesës tjetër të trupës artistike nuk i kërkohet ky orar. Ankuesit kanë pretenduar po ashtu se, që nga koha kur është emëruar A. B në krye të TKEKS, atyre nuk u është siguruar zënia me punë, duke i vënë në kushtet e një diskriminimi të hapur, gjë e cila është detyrim ligjor për t'u përmbushur, nga ana e punëdhënësit.

Në përfundim, subjektet ankues, kanë kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe ndërprerjen e situatës diskriminuese nga ana e punëdhënësit kundrejt tyre.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së⁵, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”*.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010, i ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

⁵Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Në përfundim të shqyrtimit paraprak të tri ankesave sipërcituar, Komisioneri vlerësoi se ndodhemi në kushtet e parashikimit të nenit 33, pikës 7/3 të LMD-së, në të cilin përcaktohet se: *“Në rastet kur ankesat e paraqitura pranë Komisionerit, drejtuar të njëjtit subjekt, kanë të njëjtin objekt, mund të bashkohen në një ankesë të vetme”*, dhe nëpërmjet Vendimit nr. 249, datë 21.12.2021, vendosi bashkimin e trajtimit të këtyre ankesave.
2. Nëpërmjet shkresës me nr. 1642/2 prot., datë 21.12.2021, Komisioneri ka njoftuar dhe i ka kërkuar parashtrime, subjektit kundër të cilit është paraqitur ankimimi, Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, lidhur me pretendimet e subjekteve ankues.
- Nëpërmjet shkresës me nr. 450/1 prot., datë 29.12.2021, Teatri, në përgjigje të kërkesës së Komisionerit, ndër të tjera, ka parashtruar se:

- Në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesit se, që nga muaji dhjetor 2020 nuk janë angazhuar në asnjë projekt artistik dhe nuk janë zënë me punë TKEKS, ka cituar se:

“Në ndryshim nga çfarë pretendojnë ankuesit, ju informojmë se, i takon aktorëve që të marrin pjesë në audicionet që organizohen nga regjisorët për çdo projekt artistik, me qëllim që të përfitojnë rolin përkatës, kresor apo jo kryesor, pasi TKEKS nuk mund të garantojë apo ofrojë objektivisht apriori role të menjëhershme për ta, pa u përzgjedhur më parë nga regjisorit ose pa kaluar më parë secili prej tyre në audicione.

Projektet artistike janë të një natyrë të tillë, ku vendimmarrja kryesore i përket regjisorit të veprës artistike, kjo gjë edhe për shkak të veçorive të veprimtarisë artistike. Kësisoj, diskrecionin për të zgjedhur aktorin bashkëpunues në një projekt artistik, e ka plotësisht regjisorit i veprës artistike dhe jo TKEKS si institucion publik. Në këto kushte, nuk mund të ngrihen pretendime për diskriminim nga TKEKS dhe titullati i këtij institucioni nga ankuesit, me arsyetimin se nuk i është dhënë rol në vepra artistike.

Nga ana tjetër, në pamundësi për t’u ushtruar në skenë si aktorë në role konkrete, ankuesit nuk kanë shfaqur asnjë përpjekje që të angazhohen në veprimtari të tjera artistike, të çfarëdolloj forme, duke përfshirë këtu kërkime në fushën e artit dhe kulturës, hulumtime mbi zhvillimet më të fundit në këtë fushë, trajnime profesionale (fizike, vokale, teknike) etj, pasi është detyrë e çdo zyrtari publik që ta përdorë kohën e punës në mënyrë efektive për realizimin e detyrave zyrtare, si dhe të kërkojë punë nga punëdhënësi sipas kontratës individuale”.

TKEKS ka argumentuar se, edhe pse ankuesit nuk janë angazhuar në projekte artistike, punëdhënësi ka respektuar të gjitha detyrimet kundrejt tyre, pasi edhe pse të pazënë me punë ata janë paguar plotësisht me pagë, sipas parashikimeve të kontratës individuale të punës dhe legjislacionit në fuqi dhe se ankuesit nuk janë diskriminuar në asnjë moment.

- Lidhur me pretendimin e ankuesve se u është ofruar një kontratë pune me afat të caktuar 6-mujor, në ndryshim nga pjesa tjetër e trupës artistike që u është ofruar kontratë pune me afat 1-vjeçar, TKEKS, ka parashtruar se:

“Lidhur me këtë pretendim të ankuesve, nuk ndodhemi në kushtet e diskriminimit për përkatësi në grup të veçantë, por përpara një kontrate individuale pune, ku secila nga palët ka të drejtën që të kërkojë amendime të saj, në përputhje me dispozitat e legjislacionit përkatës.

Marrë në konsideratë faktin se, ankuesit nuk po ushtroheshin me role kryesore apo jo kryesore, nga ana e TKEKS është propozuar (amendim kontrate) lidhja e kontratave individuale të punës me afat të caktuar për një periudhë 6-mujore, mbështetur në dispozitat e Kodit të Punës, të ndryshuar. Ky propozim i TKEKS bazohet në ligj dhe ai nuk u pranua nga ankuesit, e për rrjedhojë këto amendime nuk kanë hyrë kurrë në fuqi, pasi kontrata fillon të ketë efekte të dyanshme pas nënshkrimit të saj nga palët me vullnet të lirë.

Për sa më lart, ankuesit kanë ngritur pretendime eventuale dhe jo reale përpara KMD-së, e për pasojë nuk ndodhemi në kushtet e diskriminimit për shkakun e pretenduar, pasi nuk janë trajtuar aspak ndryshe nga të tjerët, sepse kontratat me afat 6-mujor nuk janë nënshkruar prej palëve”.

- Në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesit se, në ndryshim nga punonjësit e tjerë të trupës artistike u kërkohet respektimi i orarit zyrtar të punës, duke nënshkruar në regjistrin e hyrje-daljeve në institucion, TKEKS, ka argumentuar se:

“Orari zyrtar i punës është jo më pak se 8 orë pune në ditë dhe për institucionet shtetërore ai varion, nga e hëna në të enjte, ora 08:00-16:30, dhe ditën e premte, ora 08:00-14:00. Ky orar është i detyrueshëm për t’u zbatuar nga të gjithë punonjësit e institucioneve shtetërore, pasi mosrespektimi i tij sjell penalitete të zbatueshme sipas legjislacionit në fuqi dhe kontratës së punës. Në ndryshim nga çfarë parashtrohet nga ankuesit, ky orar ka qenë dhe është i zbatueshëm për të gjithë nëpunësit e institucionit, duke përfshirë administratën mbështetëse të Teatrit dhe aktorët që janë pranë tij. Të gjithë punonjësit kanë detyrimin që të nënshkruajnë në këtë regjistër dhe për pasojë pretendimet e ngritura prej tyre për diskriminim, janë faktikisht dhe ligjërisht të pabazuara”.

- Në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesit për kushtet e punës në TKEKS, Teatri ka parashtruar si më poshtë vijon:

“Sa i takon pretendimit të ngritur nga ankuesit për pamundësinë e prezencës në punë për shkak të kushteve të punës, theksojmë se, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Dega Rajonale Tiranë, në rezultatet e inspektimit të kryer, me shkresën me nr. 479 prot., datë 16.12.2021 nuk ka konstatuar mungesë të kushteve të punës, por ka rekomanduar përmirësimin e tyre lidhur me këto aspekte: “Punëdhënësi duhet të informojë punëmarrësin mbi rreziqet që lidhen me punën

dhe duhet t'i kualifikojë punëmarrësit për respektimin e kërkesave në fushën e shëndetit, sigurimit dhe higjenës”, ndaj dhe pretendimi i ankuesve është i pambështetur”.

- Në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesit për trajtim të pabarabartë midis aktorëve dhe punonjësve të administratës së TKEKS, për kushtet e punës, Teatri ka theksuar se:

“Puna e punonjësve të administratës është një punë e mirëfilltë zyre, ajo mund të realizohet vetëm në zyrë dhe nuk mund të kryhet në skenë apo në ndonjë formë tjetër, në ndryshim nga puna e aktorit që kryesisht ka për bazë shfaqjet artistike dhe nxjerrjen e produkteve artistike. Për pasojë, për shkak të natyrës së punës, edhe mënyra e ushtrimit të detyrës ndërmjet dy kategorive të punonjësve është e ndryshme dhe nuk mund të pretendohet trajtim i diferencuar kur kategoritë e punonjësve nuk janë të njëjta, e për më tepër që ndodhen në rrethana të ndryshme punësimi nga njëri-tjetri”.

3. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, më datë 02.03.2022, zhvilloi seancën dëgjimore⁶.

Seanca u zhvillua me praninë e palëve në proces. Të tre ankuesit ishin të pranishëm personalisht, TKEKS u përfaqësua nga Drejtori i Institucionit, A.B dhe Specialistja e Edukimit përmes Kulturës, R. M. I pranishëm në seancë ishte Këshilltari ligjor i Ministres së Kulturës, A. H.

Gjatë seancës dëgjimore, palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Qëndrimi i këshilltarit ligjor të Ministres së Kulturës, lidhur me pretendimet e palëve për kontratat individuale të punës me aktorët, ishte si më poshtë citojmë:

“Problematika e konstatuar vjen nga mungesa e akteve dhe normave ligjore e nënligjore. Nga njëra anë, aktori është një pasuri kombëtare, mund t'i kërkohet të angazhohet e performojë edhe jashtë orareve të punës apo tej kushteve të kontratës së punës. Nga ana tjetër, detyrat e Drejtorit të Teatrit janë më tepër të natyrës administrative, ndërsa regjisori është zot në veprën e tij. Asnjë nga palët nuk është angazhuar të përditësojë kontratën me elemente specifike që mbrojnë aktorët në punën e tyre. Kjo ka sjellë këtë situatë. Nuk është e qartë ligjërisht dhe e pa rregulluar në parashikimet në kontratën individuale të punës, çështja e së drejtës së regjisorit për të përzgjedhur aktorët në veprën e tij artistike. Në këndvështrimin tim, kontrata aktuale nuk i jep të detajuara dhe specifike tagrat e palëve në të. Situata aktuale është anormale pasi, Drejtori i Teatrit, nga njëra anë ka presionin për të realizuar projektin e Teatrit lidhur me shfaqjen artistike, ndërkohë që nga ana tjetër, regjisori mund të zgjedhë të mos angazhojë asnjë nga aktorët e Teatrit, bazuar në kërkesat e pritshmëritë e tij si autor i vënies në skenë të veprës së tij artistike. Gjithashtu, kur Drejtuesi i Teatrit firmos listëprezencat dhe mban njerëz në punë duhet t'i angazhojë me punë ata, përndryshe nuk mund të paguhen kot.

Ministria është angazhuar në miratimin e statusit për artistët, por për shkak të shumë diskutimeve e dinamikave, ende nuk është finalizuar me një akt përfundimtar”.

⁶ Referuar shkresës me nr. 291 prot., datë 09.02.2022, të Komisionerit.

Palëve iu bë e njohur e drejta për të paraqitur pranë KMD-së, prova apo parashtrime të tjera shtesë lidhur me pretendimet e tyre. Përfaqësuesit e TKEKS lanë të hapur mundësinë e rivlerësimit të kërkesës së tre aktorëve lidhur me zënien me punë nga Teatri, si dhe u dakordësua për dërgimin e informacionit lidhur me masat e ndërmarra prej tyre në vijim të seancës.

4. Në vijim të seancës dëgjimore, nëpërmjet shkresës me nr. 182 prot., datë 25.03.2022, TKEKS, informoi Komisionerin se:

“Nisur nga dakordësia e arritur në seancën dëgjimore të datës 02.03.2022, të zhvilluar pranë KMD-së, midis Teatrit dhe subjekteve ankues, për pajtim të palëve në procedimin administrative, TKEKS ka ndërmarrë veprime konkrete administrative për ta formalizuar atë. Në këtë kuadër, ankuesve u është vendosur në dispozicion më datë 15.03.2022, kontrata e re individuale e punës, me ndryshimet e reflektuara në brendësi të saj. Në përgjigje të këtij propozimi, palët ankuese nuk kanë shprehur dakordësinë për ndryshimet e kontratës përmes nënshkrimit të tyre”.

TKEKS ka bashkëlidhur parashtrimeve, propozimet/draft-kontratat individuale të punës për ankuesit, në cilësinë e dokumentacionit provues.

5. Nëpërmjet e-maileve të dërguar më datë 05.04.2022, të tre ankuesit janë tërhequr nga ankesa e tyre pranë KMD-së, duke cituar shprehimisht se kërkojnë të tërhiqen nga ankesa për shkak se mendojnë t'i japin një mundësi të re punëdhënësit dhe vetes, në kuadër të frymës bashkëpunuese dhe zënies me punë të tyre përmes angazhimit në role.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.*

Në nenin 94⁷/1 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“1. Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.*

Komisioneri konstaton se procedura administrative konkrete ka filluar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga subjektet ankues: A. T, E. Ç dhe E. Ç, të cilët me anë të kërkesës me e-mail, datë 05.04.2022 janë tërhequr nga ankesat e tyre.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri çmon se jemi në kushtet e nenit 90/3 dhe 94/1, të Kodit të Procedurave Administrative dhe për rrjedhojë procedura administrative për shqyrtimin e ankesave të tyre duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për shkak se ankuesit janë tërhequr nga ankesa.

⁷ Tërheqja e ankesës.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 3, nenin 33, pika 10 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesave me: nr. 227 Regj., nr. 228 Regj., dhe nr. 229 Regj., datë 02.12.2021⁸, respektivisht të subjekteve ankues: A. T, E. Ç dhe E. Ç, kundër Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, për shkak se ankuesit janë tërhequr nga ankesat respektive.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Punësim

Shkaku: Përkatësia në një grup të veçantë

Lloji i vendimit: Tërheqje

⁸ Ankesat janë plotësuar me informacion me datë 15.12.2021, referuar procesverbalit datë 15.12.2021, mbajtur pranë Zyrës së KMD-së.